



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 115 datë 17.12.2025

PËR

**MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MESATARE TË APARTAMENTEVE NË
TREGUN E LIRË PËR VITIN 2026 NË BASHKINË PËRMET.**

Këshilli Bashkiak Përmët i mbledhur më datën 17/12/2025, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, VKM Nr 459 datë. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", pika 2/b dhe pika 10, Vendim Nr.301, datë 15.04.2020 "Për Normat e Strehimit si dhe Kushtet e Standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", Vendim Nr. 384, Datë 12.06.2019 "Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore" pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni konsultativ i strehimit dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Të miratojë qiranë mesatare të apartamenteve në treg për vitin 2026 në Bashkinë Përmët si më poshtë:

Për apartamente të tipit Garzionere : 6 000 lekë.

Për apartamente të tipit 1+1 : 7 000 lekë.

Për apartamente të tipit 2+1 : 9 000 lekë.

- 2 - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit, Drejtoria e Financë-Buxhetit-Taksa Tregje,Zyra e Aseteve dhe Shërbimeve Publike në Bashki.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI